

Data ____/____/2024

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës – Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PER KUALIFIKIM**

(Kyproces verbal ishte per efekt publikimi bashke me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURES:"STUDIM PROJEKTIM RIKUALIFIKIMI I AKSESIT
NDËRMJET LIQENIT TË PUKËS DHE REZERVUARIT KUKAJ"**

**KODI PERKATES NË FIALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Sherbime per
projektim te arkitektures 71220000-6**

1. VLERA E FONDIT LIMIT:4.390.643 (katërmilion treqind e nëntëdhjet mijë e gjashtëqind e dyzet e tre) lekë pa tvsh

Afati i shërbimeve do të jetë për një periudhë **50 ditë**.

Në zbatim të urdhrat të grupit të specifikimeve, të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, "Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përlllogaritjen e Vlerës Limit për objektin e mësipërm, të planifikuar për t'u kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike pasi u njoh me objektin e prokurimit, programoi punën për përlllogaritjen e vlerës së projektit dhe hartimit të specifikimeve teknike duke u mbështetur në këto dokumenta:

- VKM. Nr. 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave per shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".
- Investime të kryera nga autoritete kontraktore në objekte të ngjashme.
- Buxhetin e Bashkise Pukë.

PËRLLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS

Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr.162 date 23.12.2020"Për Prokurimin Publik", dhe VKM, Nr 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", sipas të cilit:

Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i

Statistikave(INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shëmbull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtise, ne manuale eti): ose/dhe:

- a. çmimet e tregut; ose/dhe
- b. çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore:ose/dhe çmimet ndërkombetare, të botuara.

Për llogaritjen e vleres së projektit grupi i punës, siç edhe është theksuar më lart është mbështetur në Vendimin VKM. Nr. 354, datë 11.05.2016, dhe në punime të ngjashme.

Llogaritja e vlerës së projektit u bë duke u mbështetur në pikën “b” në investimet e bëra nga autoritete të tjera kontraktore (Bashkia Durrës):

- Rikonstrukcionin e segmentit rrugës “Aleksandër Goga”, nga teatri “Aleksandër Moisiu” deri në kryqëzimin te Mauzoleumi i Dëshmorëve,
 - Rikonstrukcion i rrugës “Egnatia”, si dhe
 - Rehabilitimi i dy shesheve në lagjen nr 6 dhe nr. 13, përkatësisht si me poshte:
1. **Rikualifikim hapësira publike ne lagjen nr.6**,me sipërfaqe 370 m², me vlere preventivi: 3.470.639 lekë pa tvsh. Kostoja e investimit është**9.380 lekë/m²**.
 2. **Rikualifikim hapësira publike ne lagjen nr. 13**,me një sipërfaqe prej 2074 m²., me vlerë preventivi: 15.351.953 lekë pa tvsh,kostoja e investimit është **7.402 lekë/m²**.
 3. **Rikonstrukcioni segmentit të parë të rrugës "Aleksander Goga"**, zhvillohet në njësipërfaqe rreth 11.000 m², nga Teatri “Aleksander Mojsiu” deri në kryqëzimin te Mauzoleumi i Dëshmorëve, vlere e preventivuar e rikonstrukcionit të kësaj ruge të bërëështë rreth 83.000.000 lekë pa tvsh,kostoja e investimit është**7.545 lekë/m²**.
 4. **Rikonstrukcioni i aksit rrugor Dëshmoret dhe Egnatia “Loti II”**, zhvillohet në një sipërfaqerreth 18.864 m², vlere e preventivuar e rikonstrukcionit të kësaj ruge të bërë nga Bashkia është rreth 211.488.977 lekë pa tvsh, kostoja e investimit është **11.211 lekë/m²**.

Duke marrë në analizë këto objekte kostoja për m²(K_{mes}) e investimeve të kryera është**8.884,5 lekë/m²** pa tvsh.Kosta e përafërt e llogaritur për realizimin e këtij projekti "**Rikualifikimi i aksesit ndërmjet liqenit të Pukës dhe rezervuarit Kukaj**", nisur nga investimet e bëra nga Bashkia Durrës,është:

Kosto e përgjithshme (KP) lekë = Sipërfaqe (S)m² x Kosto (K_{mes})lekë/m²
S(m²) = Gjatësia 4646m x Gjerësia (varion 3-6)m

= 4646m x 4.5m
= **20.907m²**
KP = 20.907m² x 8.884,5 leke/m²
= **185.748.242**lekë (pa tvsh)

Në gjerësinë e mësipërme (3-6)mëshhtë parashikuar: trotuar për këmbësor, korsi për biçikleta dhe korsi për vrapim, si dhe sheshe të vogla pushimi.

Mbështetur në VKM.Nr. 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Seksioni IV, Strukturat e transportit dhe qarkullimit, neni 40, 42, 44, tabela 12, tabela shoqëruese e tarifave - strukturat e transportit (qarkullimi, tabela 3: Tabela e përqindjeve mbi tarifën sipas fazave të shërbimit, për strukturat e transportit) po llogarisim më poshtë vlerën e projektit.

Vlera **185.748.242**(Kosto e llogaritshme) lekë nuk gjendet në tabelën nr. 12, tabela shoqëruese e tarifave - strukturat e transportit, kështu do të bejmë interpolimin midis dy vlerave që gjejmë në këtë tabelë, në grupin tarifor nr.III dhe pikërisht

Kostoja e llogaritshme (lekë)	Tarifa e shërbimit (%)
140.000.000	3,31 dhe 3,75
210.000.000	3,02 dhe 3,41

Duke bërë interpolimin midis këtyre vlerave na dalin koficiëntët, minimale **3.120%** dhe maksimal **3.528** %.

Kostoja e llogaritshme (lekë)	Tarifa e shërbimit (%)
185.748.242	3,120 dhe 3,528

Duke u mbështetur në këto përqindje:

- *Vlera maksimale e projektit për nëntë fazat sipas Tabela. 3 "Tabela e përqindjeve mbi tarifën, sipas fazave të shërbimit, për strukturat e transportit",*
*Është: 3.528%. * 185.748.242 = **6.553.198** lekë pa tvsh.*

Bazuar në tabelën nr. 3, Tabela e përqindjeve mbi tarifën sipas fazave të shërbimit, nga konsulenti do të kerkojmë të realizohen këto faza projektimi:

- Analiza detyrës së projektimit, 2 %
- Projekt ideja paraprake, 10%
- Projekt ideja përfundimtare 20 %
- Projekt për miratimin e lejes së ndërtimit 5%
- Projekti i zbatimi, 20%

- Preventivi përfundimtar, 10%

Shuma e këtyre fazave është: 67%.

- *Vlera maksimale e projektit për gjashtë faza:*

*67% e vlerës maksimale: 6.553.198 lekë * 67% = 4.390.643 lekë pa tvsh*

Mbështetur në llogaritë e më sipërme sipas VKM. Nr. 354, datë 11.05.2016, vlera e fondit limit për projektin "**STUDIM PROJEKTIMRIKUALIFIKIMI I AKSESIT NDËRMJET LIQENIT TË PUKËS DHE REZERVUARIT KUKAJ**" duke marrë në analizë investimet e lartpërmendura është **4.390.643 lekë pa tvsh**.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor Bashkia Pukë ka hartuar proces verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Sipas specifikimeve bashkangjitur të hartuara, vendosur dhe përlogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: "Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike (termat e referencës) dhe përlogaritjen e fondit limit", mbështetur në Vendimet të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"

I. KRITERET E VEÇANTA TEKUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzoj:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 5;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 12.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzoj:

2.1. Pershtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit.....

(shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. a. *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë “Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të lëshuara nga administrata tatimore për vitet 2021,2022,2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet”. Në plotësimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të paraqesë: Vërtetim nga Dega e Tatim-Taksave për xhiron e realizuar gjatë viteve të sipërpërmendura.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke parë vlerën e fondit limit të përcaktuar e cila nuk është e lartë dhe vlera 30% e fondit limit për xhiro vjetore nuk cenon pjesëmarrjen e op.ekonomik as atyre që janë biznes i vogël duke garantuar konkurrencë të hapur dhe mos cenimin e asnjë op.ekonomik.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Kërkohet për 3 vitet e fundit duke marrë në konsideratë vlerën e objektit dhe për të qenë sa më konkurruese për të gjithë op.ekonomikun të vegjël apo të mëdhenj.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021,2022,2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të **kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar**, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, **kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar**

Kërkohet për 3 vitet e fundit duke marrë në konsideratë vlerën e objektit dhe për të qenë sa më konkurruese për të gjithë op.ekonomikun të vegjël apo të mëdhenj.

2.2.3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2023 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

(Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomike, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomike të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojces 12 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr.9632, date 30.10.2006,Për sistemin e taksave vendore i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vëndore.

2.3 Aftesite teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqese dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në një vlerë jo më te vogël se 20 %** të vlerës së fondit të limit që prokurohet Për të vertetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomike duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojen e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të leshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotesuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojen e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotesuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara ne organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Percaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshte:

Shenim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brënda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licence të vlefshme në fushën e projektimit të leshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe të gjitha entet e tjera përgjegjëse:

ARKITEKT:

Kategoria 2.d– Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe.

PROJEKTUES INSTALATOR:

Kategoria 3.c – Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.

PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE:

Kategoria 5.c – Projektim ujësjellës kanalizime urbane - rurale.

PROJEKTUES RRUGË – HEKURUDHA:

Kategoria 6.a – Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.

PROJEKTIM URA DHE VEPRA ARTI:

Kategoria 7.a– Projektim ura dhe vepra arti të vogla deri më 10 m.

Kategoria 7.b – Projektim ura dhe vepra arti mbi 10 m.

PROJEKTUES GJEODET:

Kategoria 8.a - Rilevime inxhinierike.

Kategoria 8.b - Rilevime inxhinierike kadastrale.

Kategoria 8.c - Bazamente gjeodezike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKMnr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe në Vendimnr. 943, datë 28.12.2016 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrorjnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve tëzbatimit në ndërtim"

Argumentimi:

PROJEKTUES ARKITEKT: Kërkohe për arsyen se arkitekti do të vleresojë dhe projektojë projektin e rrugës së aksesit ndërmjet dy rezervuarëve "parkut" me elementët arkitekturore, arredimin urban etj.

PROJEKTUES INSTALATOR:Kërkohe për projektimine e elementeve elektrike që intersekojnë këtë projekt strukturorëte veprave të artit/rrugore, strukturave mbajtëse dhe pritëse.

PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE: Kërkohe për arsyen se projektuesi do të realizojë projektin e KUB e KUZ.

PROJEKTUES RRUGË - HEKURUDHA: Kërkohe për projektet e rrugëve e intersektimeve e shesheve të kësaj detyre projektimi.

PROJEKTIM URA DHE VEPRA ARTI: Kërkohe për projektimin e intersektimeve të ndryshme, përgajtë rrugës së aksesit ndërmjet dy rezervuarëve dhe përgjatë bregut të rezervuarit Kukaj.

PROJEKTUES GJEODET: Për hartimin e plan rilevimit të terreneve që do të zhvillohen.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**,si më poshtë:

- | | |
|---------------------------------|---|
| • PROJEKTUES ARKITEKT | 1 |
| • PROJEKTUES INSTALATOR. | 1 |
| • PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE. | 1 |
| • PROJEKTUES RRUGE - HEKURUDHA. | 1 |
| • PROJEKTUES GJEODET. | 1 |

Argumentimi: Nebazëtëpikës 4, tënenit77, tëligjit nr.162,datë 23.12.2020"Përprokuriminpublik" dhenenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Permiratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohe që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me suksesëkontratës:

Personeli i mësipërm kërkohe në bazë të vierësimit të natyrës së objektit dhe projektit që do të realizohet Konkretisht:

- PROJEKTUES ARKITEKTkërkohe për arsyen se arkitekti do të hartojë projektin e parkut me elementet arkitekturore, arredimin urban etj.

- PROJEKTUES INSTALATOR kërkohet për arsyen se do të realizojë projektet e ndriçimit rrugor, shesheve, nëse ka etj.
- PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE kërkohet për arsyen se do të realizojë projektet e kanalizime (KUB dhe KUZ).
- PROJEKTUES RRUGE - HEKURUDHA. kërkohet për arsyen se do të realizojë projektin e rrugës objekt prokurimi në bazë të kushteve teknike të projektimit me të gjitha elementet përbërës të një projekti.
- PROJEKTUES GJEODET kërkohet për arsyen se do të realizojë rilevimin topografik të rrugës ekzistuese.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 4 persona (Numri prej 4 personash përfshin personelin kryesor si dhe stafin mbështetës) në listpagesa sipas formularëve standart për sigurimet, për muajin e fundit, të cilit i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës. Dokumenta të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit në fuqi (*nepërmjet formës elektronike*).

Këto kritere përmbushen nepërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomike të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojces 12 të DST.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomike të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, qëka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.3.5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme

- pajisjet gjeodezike, total station, gps.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, date 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomike të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

pajisjet gjeodezike, total station, gps, janë të nevojshme sepse me anë të tyre do të bëhet rilevimi topografik i zonës ku do të shtrihet investimi.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur dhe te paraqese Certifikatat te pershtatshme **ose ekuivalentet e tyre** per objektin e prokurimit si me poshte:

- a) ISO 9001: 2015, Per menaxhimin e cilesise;
- b) ISO 14001: 2015, Per menaxhimin e cilesise se mjedisit;
- c) ISO 45001-2018 . Sistemi i Menaxhimit per Shendetin dhe Sigurine ne Punë;

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, ne varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjerisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patente, tipi ose origjine apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një menyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP.Referime të tilla duhet të shogërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

Detyra e projektimit & Termat e referencës dhe procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, të hartuara, vendosur dhe përlogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: "Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit", mbështetur në Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" janë bashkëngjitur.

Specifikime teknike/termave të referencës/detyrës së projektimit, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT, me të dhënat e mëposhteme:

Dokumentat e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kanë akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP (www.app.gov.al).

